



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

Nr. 117 Prot.

Tiranë më 06.03.2023

PROCESVERBAL

Mbledhje e Bordit Mbikqyrës të AMShC-së

Më datë 28.02.2023 në orën 12:30, në Ambjentet e AMSHC-së, sipas njoftimit u mbajt mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak ishte:

1. Paraqitja e Raportit Vjetor të AMSHC-së për vitin 2022;
2. Prezantimi i prioriteteve të thirrjes propozuar nga Shoqëria Civile;
3. Mbi procesin e Shpalljes së Thirrjes së rradhës të AMSHC-së;

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMShC-së:

1. Znj. Iris Luarasi – anëtare
2. Z. Ylljet Alicka – anëtar
3. Z. Laert Kola – anëtar
4. Znj. Vasilika Hysi – anëtare
5. Z. Bashkim Muca – anëtar
6. Z. Oltion Muzaka – anëtar
7. Znj. Eridana Cano – anëtare

Gjithshtu të pranishëm nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

1. Z. Andi Kananaj – Drejtor Ekzekutiv
2. Z. Erion Banushi – Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve
3. Z. Ferhat Aga – Specialist
4. Znj. Paula Bero - Specialiste

Fjalën e hapjes e mori Z. Andi Kananaj Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i cili ju paraqiti pjesëmarrësve në mbledhje Agjendën e takimit. Z. Kananaj kërkoi miratimin e raportit Vjetor të AMSHC-së me të cilën anëtarët e Bordit Mbikqyrës janë njohur edhe më herët në komunikimet elektronike por gjendet edhe fizikisht pranë Jush.

- Bordi Mbikqyrës e miratoi Raportin Vjetor të Agjencisë për 2022 sipas draftit të paraqitur.

Z. Kananaj gjithashtu, prezantoi relaconin në kuadër të konsultimit publik me Organizata të Shoqërisë Civile mbi përcaktimin e prioriteteve të thirrjes së rradhës dhe ftoi për të diskutuar prioritetet e propozuara nga Shoqëria Civile.

Z. Kananaj gjithashtu, u shpreh se në kuadër të ezaurimit të plotë të fondeve të vëna në dispozicion si edhe në zbatim të realizimit të të gjithë grantit të vënë në dispozicion, të nisim me procedurat, së pari duke vënë në dijeni KQZ- në lidhur me procesin grantdhënës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

Znj. Hysi u shpreh që, AMSHC-ja, në punën e saj, do të duhet të marrë shembull nga auditimet e kryera në Institucionet Publike lidhur me financimin e OJF-ve. Ndërkohë propozon që fondet të shpërndahen në afate jo të vonshme që procedura mos të shkojë afër fundit të vitit por me herët që veprimtaria e OJF-ve të jetë më e qëndrueshme dhe i matshëm implementimi i tyre.

Znj. Iris Luarasi shprehet se organizatat e reja ndeshen me shumë vështirësi në donatorë të tjerë pasi mungesa e eksperiencës i penalizon dhe e vetmja që deri tani i përkrah është AMSHC-ja.

Znj. Eridana Cana u shpreh se duhet të njihen edhe OJF-të lidhur me mbivendosjen e funksioneve të ministrive me aktivitetet e tyre.

Z. Kola ndërhyri duke u shprehur që Komisioni i Vlerësimit, do të duhet të njihet me raportet, strategjitë apo auditimet e realizuara pranë Ministrive të Linjës, në mënyrë që të shmangë çdo lloj mbivendosjeje në projektet të paraqitura për miratim.

- Në lidhje me diskutimin mbi prioritetet, anëtarët e bordit mbikqyrës, unanimisht, miratuan prioritetet dhe i kërkuan AMSHC-së të realizojë një përmbledhjen me koncize të tyre dhe t'ia bashkangjisin këtij proces-verbali.

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së shpjegon se në lidhje me procedurën e aplikimit po shikohet mundësia e implementimit të saj në e-albania. Është kryer aplikimi dhe jemi në pritje të përgjigjes nga AKSHI.

Znj. Eridana Cana shprehet shumë pozitive në lidhje me formatin e aplikimit si një risi dhe në kuadër të digjitalizimit dhe marrjes së shërbimeve online.

- Të gjithë të pranishmit u shprehën dakord për të ndjekur këtë formë aplikimi për nivelin e lartë të transparencës si dhe propozojnë për kryerjen e trajnimeve përkatëse që organizata ta kenë sa më të lehtë aplikimin.

Z. Kananaj propozoi që shuma Maksimale e financimit për projekt të jetë 2 Milionë lekë.

- Të gjithë të pranishmit ranë dakord.

Së fundmi, u ra dakord që thirrja të shpallet pasi të merret miratimi tek KQZ-ja; fituesit të shpallen pas përfundimit të zgjedhjeve vendore.

Bashkangjitur këtij proces-verbali do të gjenden dhe Prioritet e miratuara nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së.

Mbajti procesverbalin

Paula Bero

Specialist Informimi, Publikimi, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKËQYRËS

Nr. 114/1 Prot.

Tiranë, më 06 . 03 . 2023

**VENDIM**

Nr. 1 , datë 06 . 03 . 2023

Bazuar në Ligjin Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; V. K. M- së Nr. 769, dt. 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (i ndryshuar) dhe Rregullores “Mbi Procedurat e Financimit me Grante”, Bordi Mbiqyrës i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit Vjetor të AMSHC-së 2022;
2. Miratimi i prioriteteve të Thirrjes së Rradhës;
3. Shuma maksimale e vlerës së projektit është 2.000.000 (dy milionë lekë);
4. Thirrja të shpallet pas miratimit nga KQZ- ja;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për Bordin ranë dakord Kryetari dhe anëtarët si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Iris Luarasi

Kryetare e Bordit Mbikqyrës

Elira Kokona

Anëtare

Vasilika Hysi

Anëtare

Bashkim Muca

Anëtar

Ylljet Alicka

Anëtar

Eridana Cano

Anëtare

Leart Kola

Anëtar

Oltjon Muzaka

Anëtar